



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:216323

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05742356

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.863/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Perlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurve J. G.dhe D. M. , secili veç e veç për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni269 par 2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti të Përgjithshme PP/II.nr.1936/23, të datës 10.10.2023, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 27.05.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit nga Prokuroria Themelore në Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit J. G.dhe D. M. , të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 28.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.J. G., i lindur me datën ..... në Pejë, ku edhe tani banon në rr. “.....” nr. 10, i biri .... dhe nëns .... e gjinisë ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme tani student i TI-së, i punësuar në L. G. si teknik i TI-së, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të nr. personal ....., posedon telefon me numër 049/...-..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.D. M. , i lindur me datën .... në Pejë, ku edhe tani banon në “.....” nr. 8, i biri i.... dhe nëns .... e gjinisë ....., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme-student, i gjendjes se mesme ekonomike, i njohur me nr. me letërnjoftim nr. ....., posedon numër të telefonit 049/...-..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## SHPALLËN FAJTOR

Për shkak se :

Te pandehurit J. G.dhe D. M.

Me datë 09.08.2023 në ora 22:50 minuta në rr. “.....” K. Pejë pikërisht ne parkingun e pompës se derivateve “.....” te pandehurit për herë të parë pa autorizim posedon substancë narkotikë të llojit Marihuanë, në atë mënyrë që zyrtaret policor deri sa ishin duke patrulluar në vendin e lartcekur kanë ndaluar veturën të tipit M. B., ngjyrë e bardh, me targa 03-..... të cilin ishte duke drejtuar i pandehuri J., e pasagjer ishte i pandehuri D. e gjatë legjitimitit dhe bisedës me të, te pandehurit e pranojnë se ne xhepin e pantallonave te tyre posedon pa autorizim të dytë veç veç nga një qese me substancës narkotike të llojit marihuana, e cila substancë narkotike është sekuestruar, e sipas pajisjes NarTest NTX2000 substanca narkotike ka rezultuar e llojit marihuanë më peshë të përgjithshëm prej 1.4 gram

- me çka kanë kryer veprën penale "Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge" nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

## GJYKON

Të pandehurve secilit veç e veç u shqiptohet:

- I. DENIM ME GJOBË në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin detyrohen ta paguajnë të pandehurit në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe të pandehurit nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- I. Obligohen të dënuarit secili veç e veç qe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumen prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të

paguajnë shumën prej nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. Substanca narkotike e gjetur te pandehurve konfiskohet.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me dt.10.10.2023 ka ngrit aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.1936/23, kundër të pandehurve J. G.dhe D. M. , secili veç e veç për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni269 par 2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 27.05.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokuroja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, dhe të pandehurit J. G.dhe D. M., në të cilën seancë të pandehurit secili veç e veç u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale qe ju vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurores së shtetit, duke vendosur në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit, pasi qe është e qartë se kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza dhe provat e pranueshme qe e mbështetin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurorja e shtetit deklaroi “ Pasi që të pandehurit e pranuan fajësinë e ky pranim fajësie gjen mbështetjen në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoi gjykatës që të pandehurit ti shpalle fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethane lehtësuese”.

I pandehuri J. G. deklaroi “Më vjen shumë keq dhe turp që më ka ndodhur kjo dhe premtoj se nuk do të ndodhë më në të ardhmen, dhe i propozoj gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa me të lehtë”.

I pandehuri D. M. deklaroi “Më vjen shumë keq që e kam kryer këtë veprë, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëritet më, dhe kërkoj që të më shqiptoi një dënim sa me të lehtë”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074): dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese te çështjes.

Për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor të pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurve vendosi që të shqiptoj secilit veç e veç dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin detyrohen ta paguajnë të pandehurit në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që të pandehurit nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurit nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, faktin se të pandehurit tashme janë pajtuar dhe keqardhjen e shfaqur nga të pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprë penale për të cilën janë shpallur fajtor të pandehurit ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurve t’i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer dhe se lartësia e gjobës është proporcionale me nivelin e rrezikut dhe dëmit të shkaktuar me veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Gjykata është bindur se dënimet e shqiptuar të pandehurve J. G.dhe D. M. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky

dënim do të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike e cila ka qenë objekt i kryerjes së kësaj vepre penale, u morr në kuptim të nenit 269 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par. 1 dhe 2 nën par. 2.4 të KPPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.863/23, me datë 28.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale:  
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.